

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, në bazë të nenit 88 paragrafi (1) dhe (3) në lidhje me nenin 39 paragrafi (4) dhe (5) të Ligjit për gjykatat dhe Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.14 të datës 20.01.2022), më 14.07.2022, miratoi këtë:

**VENDIM**  
**për ndryshimin dhe plotësimin e**  
**Orarit vjetor**  
**të punës së Kryetarit dhe gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të**  
**Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, 03-Su.nr.57/22 të datës**  
**26.01.2022**

**Neni 1**

Në kreun III Sektori i veprave civile

**Pika V.I. Në Sektorin e veprave civile caktohen gjyqtarët NDRYSHON SI VIJON:**

**„V.I Në Sektorin e veprave civile caktohen gjyqtarët:**

- 1. Besa Ademi**
- 2. Vasil Gërçev**
- 3. Mirjana Radevska Stefkova**
- 4. Vlladimir Stojanovski**
- 5. Jelica Kërstevska**
- 6. Snezhana Gjorgjieska Zekirija**
- 7. Isamedin Limani**
- 8. Shpend Devaja**
- 9. Nake Georgiev “**

**Neni 2**

Në kreun III Sektori i veprave civile

**Pika V.III NDRYSHON SI VIJON:**

**„V.III. Këshilli i parë prej pesë gjyqtarëve, që do të veprojnë për lëndët Rev1, Rev2 dhe Rev3, do të formohet në mënyrën si vijon:**

- 1. Mirjana Radevska Stefkova – kryetare**
- 2. Vasil Gërçev - anëtar**
- 3. Vlladimir Stojanoski - anëtar**
- 4. Isamedin Limani - anëtar**

**5. Anëtari i pestë në këshillin e parë do të jetë nga tre gjyqtarët e këshillit të dytë që do të rrotojnë sipas vendimit për zgjedhje.**

Kryetarja e këshillit, gjyqtarja **Mirjana Radevska Stefkova** nuk obligohet me lëndë“.

### **Neni 3**

Në kreun III Sektori i veprave civile  
**Pika V.IV NDRYSHON SI VIJON:**

**„B.IV. Këshilli i dytë prej pesë gjyqtarëve që do të veprojnë për lëndët Rev1, Rev2 dhe Rev3, do të formohet në mënyrën si vijon:**

- 1. Shpend Devaja – kryetar**
- 2. Snezhana Gjorgjieska Zekirija – anëtare**
- 3. Jelica Kërstevska – anëtare**
- 4. Nake Georgiev - anëtar**
- 5. Anëtari i pestë në këshillin e dytë do të jetë nga tre gjyqtarët e këshillit të parë që do të rrotojnë sipas vendimit për zgjedhje.**

Kryetari i këshillit, **gjyqtari Shpend Devaja** nuk obligohet me lëndë.

Gjyqtarët që do të marrin pjesë si anëtar i pestë në këshillin e parë respektivisht në këshillin e dytë nuk do të referojnë lëndë në ato këshilla.”

### **Neni 4**

Në kreun III Sektori i veprave civile

**Pika V.VI** „Në rast të mungesës dhe pengesës për shkaqe tjera të arsyetuara të një anëtari të këshillit, zëvendësi i anëtarit do të caktohet në këtë mënyrë:

-për zëvendës të anëtarit të parë të këshillit të parë caktohet anëtari i parë i këshillit të dytë dhe anasjelltas.

-për zëvendës të anëtarit të dytë të këshillit të parë caktohet anëtari i dytë i këshillit të dytë dhe anasjelltas.

-për zëvendës të anëtarit të tretë të këshillit të parë caktohet anëtari i tretë i këshillit të dytë dhe anasjelltas.

-për zëvendës të anëtarit të katërt të këshillit të parë caktohet anëtari i katërt i këshillit të dytë dhe anasjelltas.”

**FSHIHET.**

### **Член 5**

Në kreun IV Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm  
**Pika C. IV. NDRYSHON SI VIJON:**

„**C.IV. Këshilli i dytë prej tre gjyqtarëve** për vendimmarrjen e kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në pajtim me Ligjin për gjykatat (neni 36) është si vijon:

1. **Dr. Xhemali Saiti – kryetar**
2. **Isamedin Limani – anëtar**
3. **Afrim Fidani – anëtar**

Kryetarët e këshillave, gjyqtarja **Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska** dhe gjyqtari **Dr. Xhemali Saiti**, nuk obligohen me lëndë.

Në rast të mungesës dhe pengesës dhe për shkaqe tjera të arsyetuara me kryetarët dhe anëtarët e këshillave do të zëvendësohen në mënyrë reciproke.”

#### **Neni 6**

Në kreun IV Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm  
Pika **C. VIII. NDRYSHON SI VIJON:**

“**C.VIII.** Në rast të mungesës dhe pengesës dhe për shkaqe tjera të arsyetuara, për zëvendës anëtar caktohet gjyqtarja **Cvetanka Periq.**”

#### **Neni 7**

Në kreun IV. Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm  
Pika **Ç.IV. paragrafi (2) NDRYSHON SI VIJON:**

„Në rast të mungesës dhe pengesës për shkaqe tjera të arsyetuara të Kryetarit ose një anëtar të këshillit, për zëvendës të Kryetarit të këshillit caktohet **gjyqtari Dr. Xhemali Saiti**, ndërsa për zëvendës të një anëtar të këshillit caktohet **gjyqtari Shpend Devaja.**”

#### **Neni 8**

Në kreun VI Sektori i praktikës gjyqësore  
Pika **D.I. NDRYSHON SI VIJON:**

„**D.I.** Në këtë Sektor caktohen gjyqtarët si kryetarë të sektorëve:

1. **Besa Ademi**
2. **Vasil Gërçev**
3. **Cvetanka Periq**
4. **Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska**

Për kryetar të Sektorit të praktikës gjyqësore, caktohet gjyqtari **Vasil Gërçev**, ndërsa për zëvendës të kryetarit gjyqtarja **Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska.**”

## A r s y e t i m

Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Orarit vjetor të punës së gjyqtarëve për vitin 2022 është miratuar për shkak se me aktvendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.02-1195/06 të datës 01.07.2022 është shfuqizuar aktvendimi i Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.02-875/2 të datës 14.06.2021, llogaritur nga 01.07.2022 dhe gjyqtares Mr. Snezhana Bajllozova i është konstatuar ndërprerja e funksionit të gjyqtarit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut deri më 30.06.2022, për shkak të plotësimit të kushteve për pension të moshës.

Po ashtu, me aktvendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.02-1195/8 të datës 01.07.2022, gjyqtares Lidija Martinova i është konstatuar ndërprerja e funksionit të gjyqtarit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut deri më 30.06.2022, për shkak të plotësimit të kushteve për pension të moshës.

Sipas ndryshimeve në përbërjen e këshillave, lëndët të cilat u janë dhënë gjyqtarëve me shpërndarjen automatike, ndërsa të njëjtat nuk janë referuar ose nuk është miratuar vendim, automatikisht do të rishpërndahen përmes Programit AKMIS, sipas dispozitave të Rregullores gjyqësore.

Sipas ndryshimeve në përbërjen e këshillave, lëndët që gjenden në punë të gjyqtarët, por janë të referuara ose është miratuar vendim do të përfundohen në të njëjtat këshilla.

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit, ndërsa do të zbatohet pasi të bëhet i plotfuqishëm.

### **KRYETARE E GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

**Besa Ademi**

**UDHËZIM:** Sipas nenit 39 paragrafi (11) të Ligjit për gjykatat, kundër Vendimit, gjyqtari mund të parashtrojë kundërshtim në afat prej 3-tre ditësh pas pranimit të së njëjtit.

**Dorëzuar:**

- Gjyqtarëve
- Administratorit gjyqësor
- udhëheqësve të sporteleve
- kontabilitetit
- Qendrës IT
- arkivit